| 10. Merr pëlqimin e prindit/kujdestarit ligjor për pjesëmarrje të fëmijëve në garat jashtë shkolle, përfshirë edhe pjesëmarrjen në garat ndërkombëtare. | 10. Obtains parent / legal guardian consent for children to participate in out-of-school competitions, including international competitions. | 10. Dobija saglasnost roditelja/zakonskog staratelja za učešće dece u vannastavnim aktivnostima, uključujući i učešće na međunarodnim takmičenjima |
| **Neni 12**<br>**Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit të shkollës për organizimin e garave me nxënës** | **Article 12**<br>**Duties and responsibilities of the school commission for organization of student competitions** | **Član 12**<br>**Dužnosti i odgovornosti opšinske komisije za organizovanje takmičenje sa učenicima** |
| 1. Harton planin dinamik për organizimin e garave me nxënës në nivel shkolle. | 1. Develops a dynamic plan for organizing competitions with students at school level. | 1. Sastavlja dinamičan plan za organizovanje takmičenje sa učenicima na školskom nivou. |
| 2. Formon komisionet profesionale në nivel shkolle për hartimin e instrumenteve vlerësuese sipas lëndëve dhe fushave të garave. | 2. Forms professional commissions at school level for drafting evaluation instruments according to the subjects and fields of competitions. | 2. Formira stručne komisije na nivou škole za izradu instrumenata za ocenjivanje po predmetima i oblastima takmičenja. |
| 3. Udhëheqë punën me komisionet profesionale për garat në nivel shkolle. | 3. Leads the work with professional commissions for competitions at school level. | 3. Vodi rad sa stručnim komisijama za takmičenja na nivou škole. |
| 4. Organizon, administron dhe vlerëson garat me nxënës në nivel shkolle. | 4. Organizes, administers and evaluates the competitions with students at the school level. | 4. Organizuje, administrira i ocenjuje takmičenja sa učenicima na nivou škole. |

| | | |
|---|---|---|
| 5. Bashkëpunon me aktivat profesionale për organizimin e garave dhe ofrimin e përkrahjes për nxënësit pjesëmarrës në gara të niveleve të tjera. | 5. Cooperates with professional activities to organize competitions and provide support for students participating in competitions of other levels. | 5. Sarađuje sa stručnim aktivima na organizovanje takmičenja i pružanju podrške učenicima koji učestvuju na takmičenjima drugih nivoa. |
| 6. Në bashkëpunim me komisionet profesionale dhe aktivat profesionale përzgjedh ekipin e shkollës për përfaqësim në garat komunale të diturisë. | 6. In cooperation with professional commissions and professional assets selects the school team for representation in municipal knowledge competitions. | 6. U saradnji sa stručnim komisijama i profesionalnim aktivima vrši izbor školske ekipe za predstavljanje na opštinskim takmičenjima iz znanja. |
| 7. Koordinon aktivitetet me DKA për pjesëmarrjen e nxënësve të shkollës në garat komunale dhe në nivelet tjera të organizimit të garave. | 7. Coordinates activities with MED for the participation of school students in municipal competitions and other levels of organization of competitions. | 7. Koordinira aktivnosti sa ODO za učešće učenika škole na opštinskim takmičenjima i drugim nivoima organizovanje takmičenja. |
| 8. Krijon, përditëson dhe ruan bazën e të dhënave vjetore për nxënësit pjesëmarrës në garat në nivel të shkollës dhe nxënësit e shkollës që marrin pjesë në garat në nivel komunal, në nivel shtetëror dhe në garat me karakter ndërkombëtar. | 8. Creates, updates and maintains the annual database for students participating at the school level competitions and school students participating in competitions at the municipal level, state level and in competitions of international character. | 8. Kreira, ažurira i održava godišnju bazu podataka za učenike koji učestvuju na takmičenjima na nivou škole i učenici škole koji učestvuju na takmičenjima na opštinskom nivou, na državnom nivou i na takmičenjima međunarodnog karaktera. |
| 9. Harton raporte për organizimin e garave në nivel shkolle. | 9. Compiles reports for organization of school level competitions. | 9. Sastavlja izveštaje o organizovanju takmičenja na nivou škole. |
| **Neni 13**<br>**Procedurat e zhvillimit të garave me nxënës** | **Article 13**<br>**Procedures for conducting competitions with students** | **Član 13**<br>**Procedure za održavanje takmičenja sa učenicima** |
| 1. Procedurat për zhvillimin e garave me nxënës, fillojnë në fillim të vitit të ri | 1. Procedures for conducting competitions with students begin at the beginning of the | 1. Procedure za sprovođenje takmičenja sa učenicima počinju početkom nove |

| | | |
|---|---|---|
| shkollor dhe përfundojnë në maj të vitit përkatës shkollor. | new school year and end in May of the respective school year. | školske godine i završavaju maja dotične školske godine. |
| 2. Për secilën fushë të garave me nxënës, garat zhvillohen sipas këtyre procedurave: | 2. For each field of student competitions, the competitions are held according to the following procedures: | 2. Za svaku oblast takmičenje sa učenicima, takmičenja se održavaju prema sledećim procedurama: |
| 2.1. Hartohet plani dinamik për zhvillimin e garave; | 2.1. A dynamic plan for the development of competitions is drafted; | 2.1. Izraduje se dinamički plan razvoja takmičenja; |
| 2.2. Informohen palët e interesit me planin dinamik për zhvillimin e garave në secilën fushë dhe nivel të organizimit; | 2.2. Stakeholders are informed of the dynamic plan for the development of competitions in each field and level of organization; | 2.2. Obaveštavaju se zainteresovane strane sa dinamičkim planom razvoja takmičenja u svakoj oblasti na nivo organizovanja; |
| 2.3. Ngriten komisionet profesionale vlerësuese dhe komisionet për organizimin dhe menaxhimin e garave, në varësi të specifikave të fushës së organizimit të garave dhe nivelit të organizimit; | 2.3. Professional evaluation commissions and commissions for the organization and management of competitions are established, depending on the specifics of the field of competitions organization and the level of organization; | 2.3. Uspostavljaju se Stručne komisije za ocenjivanje i komisije za organizovanje i menadžiranje takmičenja, u zavisnosti od specifičnosti oblasti organizovanje acije takmičenja i nivoa organizovanja; |
| 2.4. Anëtarët e komisioneve nënshkruajnë deklaratën në betim se nuk kanë konflikt interesi; | 2.4. The members of the commissions sign the declaration in oath that they have no conflict of interest; | 2.4. Članovi komisija potpisuju izjavu pod zakletvom da nemaju sukob interesa; |
| 2.5. Zhvillohen instrumentet vlerësuese sipas fushave të organizimit të garave; | 2.5. Evaluation instruments are developed according to the fields of competition organization; | 2.5. Razvijaju se instrumenti za ocenjivanje prema oblastima organizovanje takmičenja; |
| 2.6. Përcaktohet kohëzgjatja e garave, fillimi dhe mbarimi i garave, në varësi | 2.6. The duration of the competitions, the beginning and the end of the | 2.6. Utvrduje se trajanje takmičenja, početak i kraj takmičenja u zavisnosti |

| | | |
|---|---|---|
| të fushave të garave dhe instrumenteve vlerësuese; | competitions are determined, depending on the fields of the competitions and the evaluation instruments; | od oblasti takmičenja i instrumenate za ocenjivanje; |
| 2.7. Zhvillohen të gjitha përgatitjet teknike për organizimin e garave; | 2.7. All technical preparations for the organization of competitions are developed; | 2.7. Odvijaju se sve tehničke pripreme za organizovanje takmičenja; |
| 2.8. Sigurohen pëlqimet e prindërve/kujdestarëve ligjor për pjesëmarrje të fëmijëve në garat jashtë shkolle; | 2.8. The consent of the parents / legal guardians for the participation of the children in the out-of-school competitions is provided; | 2.8. Obezbeđena saglasnost roditelja, zakonskog staratelja za učešće dece na vanškolskim takmičenjima; |
| 2.9. Administrohen garat sipas rregullave të miratuara nga komisionet përkatëse; | 2.9. Competitions are administered according to the rules approved by the respective commissions; | 2.9. Takmičenje se administriraju prema pravilima odobrenim od strane odgovarajućih komisija; |
| 2.10. Analizohen dhe përpunohen rezultatet e garave; | 2.10. The results of the competitions are analyzed and processed; | 2.10. Rezultati takmičenja se analiziraju i obrađuju; |
| 2.11. Bëhen publike rezultatet paraprake të garave me nxënës, brenda 7 ditëve nga data e zhvillimit të garave. Për garat në fushat specifike, brenda kohës së përcaktuar nga komisioni profesional përkatës; | 2.11. Preliminary results of competitions with students are made public, within 7 days from the date of the competitions development. For competitions in specific fields, within the time determined by the relevant professional commission; | 2.11. Preliminarni rezultati takmičenja sa učenicima se objavljuju u roku od 7 dana od dana održavanja takmičenja. Za takmičenja u određenim oblastima, u roku koji odredi nadležna stručna komisija; |
| 2.12. Shqyrtohen ankimimet e nxënësve, tri ditë pas bërjes publike të rezultateve paraprake; | 2.12. Student complaints are reviewed three days after the preliminary results are made public; | 2.12. Žalbe studenata se razmatraju tri dana nakon objavljivanja preliminarnih rezultata; |

| | | |
|---|---|---|
| 2.13. Bëhen publike rezultatet përfundimtare të nxënësve pas shqyrtimit të ankimimeve të nxënësve.<br><br>3. Procedura specifike për organizimin e garave përcaktohen me konkurset përkatëse për garat me nxënës dhe me udhëzuesin për zhvillimin e garave sipas fushave dhe niveleve të organizimit.<br><br>4. Garat me nxënës që organizohen nga shkolla deri në nivelin qendror, zhvillohen në tri faza:<br><br>4.1. Faza e parë zhvillohet në nivel të institucionit edukativo-arsimor;<br><br>4.2. Faza e dytë zhvillohet në nivel komunal;<br><br>4.3. Faza e tretë zhvillohet në nivel shtetëror.<br><br>5. Për garat që zhvillohen nga institucionet arsimore, MASHTI harton kalendarin vjetor të garave, i cili duhet të përfundojë në maj të vitit përkatës shkollor. | 2.13. The final results of the students are made public after reviewing the students' complaints.<br><br>3. Specific procedures for organizing competitions are determined by the relevant contests for competitions with students and the guide for the development of competitions according to the fields and levels of organization.<br><br>4. Competitions with students that are organized from school to the central level, take place in three stages:<br><br>4.1. The first phase takes place at the level of the upbringing-educational institution;<br><br>4.2. The second phase takes place at the municipal level;<br><br>4.3. The third phase takes place at the state level.<br><br>5. For competitions held by educational institutions, MESTI compiles the annual calendar of competitions, which must end in May of the respective school year. | 2.13. Konačni rezultati učenika se objavljuju nakon razmatranja žalbi studenata.<br><br>3. Konkretne procedure za organizovanje takmičenja utvrđuju se relevantnim konkursima za takmičenja sa učenicima i vodičem za održavanje takmičenja prema oblastima i nivoima organizovanja.<br><br>4. Takmičenja sa učenicima koja se organizuju škole pa sve do centralnog nivoa, odvijaju se u tri faze:<br><br>4.1. Prva faza se odvija na nivou edukativno-obrazovne institucije;<br><br>4.2. Druga faza se odvija na opštinskom nivou;<br><br>4.3. Treća faza se odvija na državnom nivou.<br><br>5. Za takmičenja koje održavaju obrazovne institucije, MONTI sačinjava godišnji kalendar takmičenja, koji se mora završiti maja dotične školske godine. |

| Neni 14<br>**Pjesëmarrja e nxënësve në gara të fushave të ndryshme** | Article 14<br>**Participation of students in competitions of different fields** | Član 14<br>**Učešće učenika u različitim oblastima** |
|---|---|---|
| 1. Në gara mund të marrin pjesë të gjithë nxënësit e arsimit parauniversitar të institucioneve arsimore publike dhe private, në klasat dhe nivelet e arsimit për të cilat organizohen garat me nxënës, të përcaktuara me këtë udhëzim administrativ. | 1. The competitions can be attended by all students of pre-university education of public and private educational institutions, in the classes and education levels for which competitions are organized with students defined by this administrative instruction. | 1. Na takmičenjima mogu učestvovati sve učenici preduniverzitetskog obrazovanja javnih i privatnih obrazovnih institucija, u razredima i nivoima obrazovanja za koje se organizuju takmičenja sa učenicima, utvrđenim ovim administrativnim uputstvom. |
| 2. Qasja e pjesëmarrjes në sistemin e garave është vullnetare, me pajtim të nxënësit/es pa ndonjë imponim dhe i shërben nxitjes dhe motivimit të nxënësve për të qenë garues me bashkëmoshatarët e tij/saj në fusha të ndryshme me interes për nxënësin. | 2. The approach to participation in the competition system is voluntary, with the consent of the student without any imposition and serves to encourage and motivate the student to be competitive with his / her peers in various areas of interest to the student. | 2. Pristup učešću u sistemu takmičenja je dobrovoljan, uz saglasnost učenika/ce bez ikakvog nametanja i služi da podstakne i motiviše učenika da bude konkurentan svojim vršnjacima u različitim oblastima od interesa za učenika. |
| 3. Institucionet arsimore bëjnë të gjitha angazhimet që të nxisin interesimin dhe pjesëmarrjen e nxënësve në gara, në fushat për të cilat vlerësohet se ka potenciale dhe mundësi të garimit. | 3. Educational institutions make every effort to promote the interest and participation of students in competitions, in areas for which it is estimated that there are potentials and opportunities for competition. | 3. Obrazovne institucije se maksimalno trude da promovišu interesovanje i učešće učenika na takmičenjima, u oblastima za koje se procenjuje da imaju potencijal i mogućnosti za takmičenje. |
| 4. Pjesëmarrja e nxënësve në gara bëhet sipas klasave, niveleve të arsimit, niveleve të organizimit (nivel shkolle, nivel komunal dhe në nivel shtetëror), fushave të organizimit të garave dhe përcaktimeve me | 4. The participation of students in competitions is done according to grades, education levels, organization levels (school level, municipal level and state level), areas of competition organization | 4. Učešće učenika na takmičenjima vrši se prema razredima, nivo obrazovanja, nivoima organizovanja (školski, opštinski i državni nivo), oblastima organizovanje organizovanje takmičenja i definisanjem sa |

| | | |
|---|---|---|
| këtë UA. | and determinations with this AI. | ovom AU. |
| 5. Për garat në fusha të veçanta, MASHTI cakton numrin e nxënësve/ekipeve të shkollave për pjesëmarrje në garat komunale dhe garat nacionale. Kriter për caktimin e numrit të nxënësve/ekipeve të shkollave merren: fusha specifike e garave, numri i shkollave në nivelin përkatës dhe numri i nxënësve në vitin përkatës shkollor. | 5. For competitions in specific fields, MESTI determines the number of students / school teams to participate in municipal competitions and national competitions. Criteria for determining the number of students / school teams are taken: the specific field of competition, the number of schools at the respective level and the number of students in the respective school year. | 5. Za takmičenja u određenim oblastima, MONTI određuje broj učenika/školskih ekipa koje će učestvovati na opštinskim takmičenjima i nacionalnim takmičenjima. Kriterijumi za određivanje broja učenika/školskih ekipa su: specifična oblast takmičenja, broj škola na odgovarajućem nivou i broj učenika u odgovarajućoj školskoj godini. |
| **Neni 15**<br>**Fushat e organizimit të garave me nxënës** | **Article 15**<br>**Areas of competition organization with students** | **Član 15**<br>**Oblast za organizovanje takmičenja sa učenicima** |
| 1. Fushat e organizimit të garave: | 1. Areas of competition organization: | 1. Oblast za organizovanje takmičenja: |
| 1.1. Garat e diturisë; | 1.1. Knowledge competitions; | 1.1. Takmićenje u znanje; |
| 1.2. Garat për fushat artistike; | 1.2. Competitions for artistic areas; | 1.2. Takmićenje u oblasti umetnosti; |
| 1.3. Garat për kreativitet dhe inovacion; | 1.3. Competitions for creativity and innovation; | 1.3. Takmićenje u oblasti kreativnost i inovacije; |
| 1.4. Garat e debatit. | 1.4. The debate competitions. | 1.4. Takmićenje u debate. |
| 2. Garat e sportit organizohen nga Federata e Sportit Shkollor e Kosovës. | 2. Sports competitions are organized by the School Sports Federation of Kosova. | 2. Sportska takmičenja organizuje Savez školskog sporta Kosova. |
| 3. Garat mund të organizohen në formate të ndryshme, në përputhje me nivelet e | 3. Competitions can be organized in different formats, according to the | 3. Takmičenja se mogu organizovati u različitim formatima, prema nivou |

| | | |
|---|---|---|
| shkollimit, në formë individuale, në çifte apo në ekipe, në përputhje me kriteret dhe konkurset për pjesëmarrje në gara. | education levels, in individual form, in pairs or in teams, in accordance with the criteria and competitions for participation in competitions. | školovanja, u individualnoj formi, u parovima ili ekipno, u skladu sa kriterijumima i konkursima za učešće na takmičenjima. |
| **Neni 16**<br>**Organizimi i garave të diturisë** | **Article 16**<br>**Organization of the knowledge competition** | **Član 16**<br>**Organizovanje takmičenje u znanje** |
| 1. Garat e diturisë organizohen në baza vjetore për nxënësit e klasave të pesta (5) dhe nxënësit e klasave të nënta (9). | 1. Knowledge competitions are organized on an annual basis for fifth graders (5) and ninth graders (9). | 1. Takmičenje u znanju se organizuje na godišnjem nivou za učenike učenike petog (5) i učenike devetog razreda (9). |
| 2. Në klasën e pestë (5) garat e diturisë organizohen në fusha kurrikulare/lëndë: Gjuhë amtare dhe matematikë, shkencat e natyrës, shkencat shoqërore. Garat e diturisë në klasën e pestë (5) organizohen vetëm në nivel të shkollës. | 2. In the fifth grade (5) knowledge competitions are organized in curricular areas / subjects: Mother Tongue and Mathematics, Natural Sciences, Social Sciences. Knowledge competitions in the fifth grade (5) are organized only at the school level. | 2. U petom razredu (5) organizuju se takmičenja u znanju iz oblast kurikuluma/predmeta: Maternji jezik i matematika, prirodne nauke, društvene nauke. Takmičenje u znanju u petom razredu (5) organizuje se samo na nivou škole. |
| 3. Në klasën e nëntë (9) garat e diturisë organizohen në fusha kurrikulare/lëndë: Gjuhë amtare, gjuhë angleze, histori, gjeografi, edukatë qytetare, matematikë, fizikë, kimi, biologji, TIK. | 3. In the ninth grade (9) knowledge competitions are organized in curricular areas / subjects: Mother Tongue, English language, History, Geography, Civic Education, Mathematics, Physics, Chemistry, Biology, ICT. | 3. U devetom razredu (9) organizuju se takmičenja u znanju iz oblast kurikulum/predmeta: Maternji jezik, engleski, istorija, geografija, građansko obrazovanje, matematika, fizika, hemija, biologija, TIK. |
| 4. Garat e diturisë për nxënësit e klasave të nënta (9) organizohen në nivel shkolle, nivel komunal dhe në nivel qendror. | 4. Knowledge competitions ninth grade students (9) are organized at school level, municipal level and central level. | 4. Takmičenje u znanju za učenike devetog (9) razreda se organizuju na nivou škole, opštinskog i centralnog nivoa. |
| 5. Mënyra e organizimit të garave të diturisë në nivel shkolle është individuale, | 5. The way of organizing knowledge competitions at school level is individual, | 5. Način organizovanja takmičenja u znanju na nivou škole je individualan, dok |

| | | |
|---|---|---|
| ndërsa në nivel komunal dhe në nivel qendror, garat e diturisë me nxënësit e klasës së nëntë (9) organizohen me grupe/ekipe të shkollave që përfaqësojnë të gjitha fushat/lëndët e përfshira në gara të diturisë. | while at the municipal level and at the central level, knowledge competitions with ninth grade (9) students are organized with groups / teams of schools that represent all fields / subjects involved in knowledge competitions. | na opštinskom i centralnom nivou takmičenja u znanju sa učenicima devetog razreda (9) organizuju sa školskim grupama/ekipama koje predstavljaju sve oblasti/predmete uključene u takmičenje znanja. |
| 6. Ekipi i shkollës për përfaqësim në garat e diturisë në nivel komunal formohet nga lista e nxënësve fitues të garave në nivel shkolle. Ekipi i shkollës që fiton garat komunale, përfaqëson komunën në garat në nivel qendror. | 6. The school team for representation in knowledge competitions at the municipal level is formed from the list of students winning school-level competitions. The school team that wins the municipal competitions represents the municipality at the central level competitions. | 6. Školski tim za predstavljanje na takmičenjima iz znanja na opštinskom nivou formira se sa spiska učenika koji pobeđuju na takmičenjima na nivou škole. Školske ekipa koja pobedi na opštinskom takmičenju predstavlja opštinu na takmičenjima centralnog nivoa. |
| 7. Modalitetet e organizimit të garave të diturisë mund të jenë të ndryshme, me teste, me formatin e kuizeve (me publik apo pa publik), apo të kombinuar. Për modalitetet vendoset nga komisionet gjegjëse (shkollë, DKA, MASHTI). | 7. The modalities of organizing knowledge competitions can be different, with tests, with the format of quizzes (with public or without public), or combined. The modalities are decided by the respective commissions (School, MED, MESTI). | 7. Modaliteti organizovanja takmičenja u znanju mogu biti različiti, sa testovima, sa formatom kvizova (sa javnim ili bez javnosti), ili kombinovani. O modalitetima odlučuju odgovarajuće komisije (školska, ODO, MONTI). |
| 8. Për modalitetet e organizimit të garave, nxënësit paraprakisht duhet të jenë të informuar. | 8. Students should be informed in advance about the modalities of organizing competitions. | 8. O modalitetima organizovanja takmičenja, učenici treba unapred da budu obavešteni. |
| 9. Instrumentet vlerësuese për garat e diturisë me nxënës, me kërkesa (pyetje dhe detyra) për lëndë/fusha të përfshira në gara, zhvillohen nga komisionet e posaçme profesionale: | 9. Assessment instruments for knowledge competitions with students, with requests (questions and assignments) for subjects / areas included in the competitions, are developed by special professional commissions: | 9. Instrumente ocenjivanja za takmičenja u znanju sa učenicima, sa zahtevima (pitanjima i zadacima) za predmete/oblasti obuhvaćene u takmičenju, izrađuju posebne stručne komisije: |

| | | |
|---|---|---|
| 9.1. Në nivel shkolle, nga mësimdhënësit e shkollës, të lëndëve të përfshira në garat e diturisë; | 9.1. At the school level, by the school teachers, of the subjects included in the knowledge competitions. | 9.1. Na nivou škole, od strane školskih nastavnika, predmeta uključenih u takmičenja u znanju; |
| 9.2. Në nivel komunal, nga mësimdhënës të shkollave në nivel të komunës; | 9.2. At the municipal level, by school teachers at the municipal level. | 9.2. Na opštinskom nivou, od strane školskih nastavnika na opštinskom nivou; |
| 9.3. Në nivel shtetëror, nga ekspertë të pavarur të lëndëve, profesorë universitarë dhe mësimdhënës të shkollave të ndryshme; | 9.3. At the state level, by independent subject experts, university professors and teachers of different schools. | 9.3. Na državnom nivou, od strane nezavisnih predmetnih stručnjaka, univerzitetskih profesora i nastavnika različitih škola; |
| 9.4. MASHTI në bashkëpunim me DKA-të, mund të hartojë teste të standardizuara për garat e diturisë në nivel shkolle dhe komune. | 9.4. MESTI in cooperation with MEDs, can design standardized tests for knowledge competitions at school and municipal level. | 9.4. MONTI u saradnji sa ODO može da sastavi standardizovane testove za takmičenje u znanju na školskom i opštinskom nivou. |
| 10. Kërkesat për garat e diturisë (pyetjet, detyrat), hartohen në përputhje me kurrikulat përkatëse, me forma të ndryshme (të mbyllura, të hapura, të kombinuara, me plotësim, etj.), si dhe me përfshirje të të gjitha niveleve të vështirësive të kërkesave. | 10. Requirements for knowledge competitions (questions, tasks), are drafted in accordance with the relevant curricula, in different forms (closed, open, combined, with completion, etc.), as well as with the inclusion of all levels of difficulty requests. | 10. Zahtevi za takmičenja u znanju (pitanja, zadaci), izrađuju se u skladu sa odgovarajućim kurikulumom, u različitim oblicima (zatvoreni, otvoreni, kombinovani, sa popunjavanjem sl.), kao i uključivanjem zahteva svih nivoa poteškoća. |
| 11. Garat e diturisë si në nivel shkolle, ashtu edhe në nivel komunal dhe në nivel qendror, organizohen në kohën kur nuk pengohet procesi i rregullt i mësimit. | 11. Knowledge competitions both at the school level, at the municipal level and at the central level, are organized at a time when the regular learning process is not obstructed. | 11. Takmičenje u znanju na nivou škole, kao i na opštinskom i na centralnom nivou, organizuje se u vreme kada ne ometa redovnom redovan proces nastave. |
| 12. Nxënësit e shkollës që kanë zënë vendin e parë në garat e diturisë në nivel | 12. School students who have taken first place in knowledge competitions at the | 12. Učenici škole koji su uzeli prva mesta na takmičenjima znanja na centralnom |

| | | |
|---|---|---|
| qendror, mbështeten nga MASHTI për të marrë pjesë në garat regjionale dhe ndërkombëtare që organizohen me pjesëmarrje të ekipeve të shkollave apo individuale. | central level, are supported by MESTI to participate in regional and international competitions organized with the participation of school teams or individuals. | nivou, dobijaju podršku MONTI-a da učestvuju na regionalnim i međunarodnim takmičenjima koja se organizuju uz učešće školskih ili pojedinačnih timova. |
| 13. Në secilin nivel të organizimit të garave të diturisë me nxënës (në nivel shkolle, në nivel komunal dhe në nivel shtetëror), shpallen 3 nxënësit më të mirë apo tri ekipet më të mirat, të cilët promovohen dhe shpërblehen nga institucioni përkatës. | 13. At each level of organization of knowledge competitions with students (at school level, at municipal level and at state level), announced the 3 best students or the three best teams, who are promoted and awarded by the relevant institution. | 13. Na svakom nivou organizovanja takmičenja u znanju sa učenicima (na školskom, opštinskom i državnom nivou) proglašavaju se 3 najbolja učenika ili tri najbolja tima, koje se promoviše i nagrađuje odgovarajuća institucija. |
| **Neni 17**<br>**Garat për fushat artistike** | **Article 17**<br>**Competitions for artistic areas** | **Član 17**<br>**Takmićenje u oblasti umetnosti** |
| 1. Garat për fushat artistike, organizohen për nxënësit e klasave dhe niveleve të ndryshme të shkollimit, në mënyrë individuale dhe/apo në grupe/ekipe. | 1. Competitions for artistic areas, are organized for students of different grades and education levels, individually and / or in groups / teams. | 1. Takmićenje za umetne oblasti, se organizuju za učenike različitih razreda i nivoa školovanja, pojedinačno i/ili grupno/ekipno. |
| 2. Për nivelin fillor (klasa 1-5), garat në fushat artistike organizohen në: vizatim, pikturë, skulpturë, interpretim individual/ vokal - instrumental. Garat e nivelit fillor organizohen vetëm në nivel shkolle. | 2. For the primary level (grades 1-5), competitions in artistic fields are organized in: drawing, painting, sculpture, individual / vocal-instrumental interpretation. Primary level competitions are organized only at the school level. | 2. Za osnovni nivo (razred od 1-5. Razred) takmičenja iz oblast umetnost organizuju se: crteža, slikarstvo, vajanja, individualne/vokalno-instrumentalne interpretacije. Takmičenja u osnovnom nivou organizuju se samo na nivou škole. |
| 3. Për nivelin e mesëm të ulët (klasa 6-9) dhe të mesëm të lartë (klasat 10-12), garat për fushat artistike organizohen në nivel shkolle, nivel komunal dhe në nivelin | 3. For lower secondary level (grades 6-9) and higher secondary level (grades 10-12), competitions for artistic fields are organized at school level, municipal level | 3. Za niži srednje nivo (6-9 razred) i viši srednji nivo (10-12 razred), takmičenja iz oblasti umetnost organizuju se na nivou škole, na opštinskom i državnog nivou. |

| | | |
|---|---|---|
| shtetëror. Garat në fushat artistike në këto nivele, përfshijnë tematika të veçanta nga: | and state level. Competitions in the artistic fields at these levels include specific topics from: | Takmičenja u oblasti umetnost na ovim nivoima obuhvataju specifične teme iz: |
| 3.1. Arti figurativ (vizatim, pikturë, skulpturë, dizajn; | 3.1. Figurative art (drawing, painting, sculpture, design. | 3.1. Likovna umetnost (crtanje, slikanje, skulptura, dizajn; |
| 3.2. Arti letrar (ese, poezi, tregim, përrallë, dramë; | 3.2. Literary art (essay, poetry, story, fairy tale, drama. | 3.2. Književna umetnost (esej, poezija, priča, bajka, drama; |
| 3.3. Arti muzikor (muzikë vokale, muzikë instrumentale dhe vokalo-instrumental); | 3.3. Musical art (vocal music, instrumental music and vocal-instrumental). | 3.3. Muzička umetnost (vokalna muzika, instrumentalna muzika i vokalno-instrumentalna muzika); |
| 3.4. Vallëzim/et (valle popullore, balet, vallëzim modern. | 3.4. Dance/s (folk dance, ballet, modern dance. | 3.4. Ples (narodne igre, balet, savremene igre. |
| 4. MASHTI çdo vit përcakton fushat tematike prioritare për organizimin e garave artistike dhe mënyrën e pjesëmarrjes në gara (individuale apo në grupe sipas fushave artistike), të cilat janë pika referimi për hapjen e konkurseve në nivel shkolle, komune dhe në nivel shtetëror. | 4. MESTI annually determines the priority thematic areas for the organization of artistic competitions and the way of participation in competitions (individually or in groups according to artistic fields), which are the reference point for opening competitions at school, municipal and state level. | 4. MONTI svake godine određuje prioritetne tematske oblasti za organizovanje umetničkih takmičenja i način učešća na takmičenjima (pojedinačno ili grupno prema umetničkim oblastima), koje su referentna tačka za otvaranje takmičenja na školskom, opštinskom i državnom nivou. |
| 5. Me konkurset përkatëse (në nivel shkolle, në nivel komunal dhe në nivel shtetëror) nxiten nxënësit me talente dhe interesime që të konkurrojnë me punimet, kreacionet, produktet dhe performancat e tyre artistike brenda një afati të caktuar me konkurset përkatëse. | 5. With relevant competitions (at school level, municipal level and state level) are encouraged students with talents and interests to compete with their works, creations, products and artistic performances within a certain deadline with the respective competitions. | 5. Relevantnim konkursima (na školskom, opštinskom i državnom nivou) podstiču učenike sa talentom i interesovanjem da se svojim radovima, kreacijama, proizvodima i umetničkim nastupima u određenom roku takmiče na odgovarajućim konkursima. |

| | | |
|---|---|---|
| 6. Në secilin nivel të organizimit të garave artistike, ngritën komisione profesionale vlerësuese:<br><br>6.1. Në nivel shkolle, nga mësimdhënësit e shkollës - fusha/lëndët e artit;<br><br>6.2. Në nivel komunal, nga mësimdhënës të fushave të artit nga shkollat e ndryshme të komunës;<br><br>6.3. Në nivel shtetëror, nga artistë të pavarur, profesorë universitarë dhe mësimdhënës të shkollave nga fushat përkatëse të artit. | 6. At each organization level of artistic competitions, professional evaluation commissions are established:<br><br>6.1. At the school level, by the school teachers-fields / subjects of art;<br><br>6.2. At the municipal level, by art teachers from different schools in the municipality;<br><br>6.3. At the state level, by independent artists, university professors and school teachers from relevant art area. | 6. Na svakom nivou organizovanje likovnog takmičenja, pokreću se stručne ocenjivačke komisije:<br><br>6.1. Na nivou škole, od školskih nastavnika - oblasti/ predmeti umetnosti;<br><br>6.2. Na opštinskom nivou, nastavnici likovne oblasti iz različitih škola u opštini;<br><br>6.3. Na državnom nivou, samostalni umetnici, univerzitetski profesori i nastavnici iz relevantnih umetničke oblasti. |
| 7. Numri i anëtarëve të komisioneve profesionale, përcaktohet sipas fushave artistike, në nivel komunal dhe në nivel shtetëror, jo më pak se tre (3) anëtarë për një fushë artistike. | 7. The number of professional commission member is determined according to the artistic fields, at municipal level and at state level, not less than three (3) members for an artistic field. | 7. Broj članova stručnih komisija utvrđuje se prema oblastima umetnosti, na nivou opštine i na nivou države, najmanje tri (3) člana za umetničku oblast. |
| 8. Garat për fushat artistike organizohen në ditë të ndryshme, sipas fushave tematike të arteve dhe planit dinamik për organizimin e garave. | 8. Competitions for artistic fields are organized on different days, according to the thematic fields of arts and the dynamic plan for organizing competitions. | 8. Takmičenja za umetničke oblasti organizuju se različitim danima, prema tematskim oblastima umetnosti i dinamičkom planu organizovanja takmičenja. |
| 9. Bazuar në vlerësimin më të lartë për punimet, kreacionet, produktet dhe performancat artistike më cilësore dhe më | 9. Based on the highest rating for the highest quality and most original works, creations, products and artistic | 9. Na osnovu najviše ocene za najkvalitetnije i najoriginalnije radove, kreacije, proizvode i umetničke nastupe na |

| | | |
|---|---|---|
| origjinale në secilin nivel të organizimit të garave (në nivel shkolle, komune dhe në nivel shtetëror) shpallen nxënësit apo ekipet më të mira në secilën fushë artistike të garimit. | performances at each level of competition organization (at school, municipal and state level) are announced the best students or teams in each artistic field of competition. | svakom nivou organizovanje takmičenja (na školskom, opštinskom i državnom nivou), proglašavaju se najbolji učenici ili ekipe u svakoj umetničkoj oblasti. |
| 10. Nëse komisionet kanë arsye të qëndrueshme për të dyshuar se ndonjë punim, kreacion a produkt artistik i nxënësve nuk është origjinal i nxënësit/ve, ata kanë të drejtë të kërkojnë dëshmi shtesë duke kërkuar ripërsëritje të detyrës ose pjesë të saj. | 10. If the commissions have good reason to suspect that a student's work, creation or art product is not the student's original, they have the right to request additional evidence by requesting a repetition of the assignment or part of it. | 10. Ako komisije imaju ubedljive razloge da sumnjaju da rad, stvaralaštvo ili umetnički proizvod učenika nisu originalni, imaju pravo da traže dodatne dokaze tražeći ponavljanje zadatka ili njegovog dela. |
| 11. Nxënësit e shpallur fitues nga shkolla marrin pjesë në garat në nivel komune, pastaj nxënësit fitues në garat komunale përfaqësojnë komunën në garat artistike të nivelit shtetëror, nxënësit fitues të garave në nivel shtetëror përfaqësojnë Republikën e Kosovës në garat ndërkombëtare, garat e fushave të njëjta. | 11. The declared students from the school participate in the competitions at the municipal level, then the winning students in the municipal competitions represent the municipality in the state-level artistic competitions, the winning students represent the Republic of Kosova in the international competitions, competitions of the same fields. | 11. Učenici koji su proglašeni pobednicima iz škole učestvuju na takmičenjima na opštinskom nivou, zatim učenici pobednici na opštinskim takmičenjima predstavljaju opštinu na državnim takmičenjima umetnosti, učenici pobednici predstavljaju Republiku Kosovo na međunarodnim takmičenjima, takmičenjima iz istih oblasti. |
| 12. Në secilin nivel të organizimit të garave artistike me nxënës (në nivel shkolle, në nivel komune dhe në nivel shtetëror), nxënësit më të mirë që zënë vendet e para në fushat përkatëse artistike apo ekipet e vendeve të para, promovohen dhe shpërblehen nga institucioni në nivelin përkatës të garave. | 12. At each level of organizing artistic competitions with students (at school level, at municipal level and at state level), the best students taking first places in the respective artistic fields or the teams of the first places, are promoted and rewarded by the institution in the relevant level of competition. | 12. Na svakom nivou organizovanja takmičenja iz umetnosti sa učenicima (na nivou škole, na nivou opštine i na državnom nivou), najbolji učenici koji zauzmu prva mesta u odgovarajućim umetničkim oblastima ili prvoplasirane ekipe, promovišu se i nagrađuju od strane institucija na relevantnom nivou takmičenja. |

| Neni 18<br>Garat për kreativitet dhe inovacion | Article 18<br>Competitions for creativity and innovation | Član 18<br>Takmićenje u oblasti kreativnost i inovacije |
|---|---|---|
| 1. Garat për ide a projekte kreative dhe/ose inovative organizohen çdo vit nga MASHT-i, në bashkëpunim me DKA-të e shkollat dhe përfshijnë nxënësit nga klasa 6 gjer në klasën 12. | 1. Competitions for creative and / or innovative ideas or projects are organized every year by MESTI, in cooperation with MEDs and schools and include students from grade 6 to grade 12. | 1. Takmičenja za ideju ili kreativni projekat i/ili inovacione organizuje svake godine MONTI , u saradnji sa ODO i školama i uključuju učenika šestog 6 pa sve do 12-tog razreda. |
| 2. Garat organizohen në formë të një konkursi të shpallur nga MASHTI çdo vit. | 2. The competitions are organized in the form of a competition announced by MESTI every year. | 2. Takmičenja se organizuje u obliku konkursa koji objavljuje MONTI. |
| 3. MASHTI krijon një komision profesional me ekspertë të pavarur e kompetentë të fushave të ndryshme, të cilët e hartojnë përmbajtjen e konkursit, ku specifikojnë kushtet dhe kriteret që duhet të plotësojë një ide ose projekt i nxënësve për t'u cilësuar si ide a projekt kreativ dhe/ose inovativ. | 3. MESTI creates a professional commission with independent and competent experts in various fields, who draft the content of the competition, specifying the conditions and criteria that must meet an idea or project of students to be considered as a creative idea or project and / or innovative. | 3. MONTI formira profesionalnu komisiju sa nezavisnim i kompetentnim ekspertima iz različitih oblasti koji sastavljaju sadržaj konkurs, u kojem se navode uslovi i kriterijumi koji moraju ispunjavati ideju ili projekat učenika kako bi okarakterisao kao projekat ili ideja kreativni i / ili inovativni. |
| 4. MASHTI përmes DKA-ve i informon shkollat, përkatësisht nxënësit, për konkursin, në mënyrë që secili nxënës i interesuar të mund të aplikojë në kuadër të këtij konkursi. Pas mbylljes së konkursit, komisioni i MASHTI-it do ta bëjë vlerësimin e të gjitha ideve e projekteve kreative dhe/ose inovative që janë dorëzuar nga nxënësit përmes shkollave dhe DKA- | 4. MESTI through MEDs informs the schools, respectively the students, about the competition, so that every interested student can apply within this competition. After the closing of the competition, the MESTI commission will evaluate all creative and / or innovative ideas and projects that have been submitted by students through schools and MEDs. | 4. MONTI preko ODO informiše škole, odnosno učenike, o konkursu, tako da svaki zainteresovani učenik može da se prijavi u okviru ovog konkursa. Nakon zatvaranja konkursa, komisija MONT-a će proceniti sve ideje i kreativnih projekata i / ili inovativne projekte koje su učenici predali preko škole i ODO. |

| | | |
|---|---|---|
| ve. | | |
| 5. Pas vlerësimit, komisioni përzgjedhë dhe shpallë 10 nxënësit me idetë a projektet kreative dhe/ose inovative më cilësoret dhe më origjinalet (dhjetë vendet e para të ranguara nga 1 deri në 10) në nivel vendi, promovohen dhe shpërblehen nga MASHTI. | 5. After the evaluation, the commission selects and announces 10 students with creative and / or innovative ideas or projects of the highest quality and most original (top ten places from 1 to 10) at the national level, promoted and awarded by the MESTI. | 5. Nakon ocenjivanje, komisija bira i proglašava 10 učenika sa idejama ili kreativnim projektima i/ili inovacionim što više kvalitetnijim i što originalnijim ( deset prvo rangirana mesta od 1 do 10) na državnom nivou, promovišu se i nagrađuju od strane MONTI. |
| 6. MASHTI do të përkrahë financiarisht realizimin praktik të tri ideve/projekteve të para kreative/inovative. | 6. MEST will financially support the practical implementation of the first three creative / innovative ideas / projects. | 6. MONTI će finansijski podržati praktičnu realizaciju tri prve ideje/projekte prve kreativne /inovativne |
| **Neni 19**<br>**Garat e debatit** | **Article 19**<br>**The debate competitions** | **Član 19**<br>**Takmićenje u debate** |
| 1. Garat e debatit organizohen çdo vit nga MASHTI, në bashkëpunim me DKA-të e shkollat dhe përfshijnë nxënësit e klasave 8-9 dhe klasave 10-12. | 1. The debate competitions are organized every year by MESTI, in cooperation with MEDs and schools and include students from 8-9 to 10-12 grades. | 1. Takmičenja u debate organizuju se svake godine od strane MONTI, u saradnji sa ODO i školama i uključuju učenika od 8-9 razred i 10-12 razreda. |
| 2. Për organizimin e garave të debatit, MASHTI përcakton temat për debate (tema të përgjithshme që lidhen me rolin e të rinjve në shoqëri, debate për tema sociale, arsim, shëndetësi, teknologji, mjedis, kulturë, art, sport, etj.) bën thirrje publike dhe përzgjedhë organizatat e specializuara të certifikuara për organizimin e debateve të standardizuara. | 2. For the organization of debate competitions, MESTI defines topics for debates (general topics related to the role of youngsters in society, debates on social topics, education, health, technology, environment, culture, art, sports, etc.) calls public and selects specialized certified organizations for organizing standardized debates. | 2. Za organizovanje takmičenja u debati, MONT definiše teme za debate (opšte teme vezane za ulogu mladih u društvu, debate o društvenim temama, obrazovanje, zdravstvo, tehnologiju, životnu sredinu, kulturu, umetnost, sport i dr.) poziva javne i bira specijalizovane sertifikovane organizacije za organizovanje standardizovanih debata. |
| 3. MASHTI përmes DKA-ve i informon | 3. MESTI through MEDs informs schools | 3. MONTI preko ODO-a informiše škole i |

| | | |
|---|---|---|
| shkollat dhe nxënësit për temat e debateve, dinamikën e konkursit për pjesëmarrje në garat e debatit, në mënyrë që secila shkollë e interesuar të mund të aplikojë me një ose disa ekipe të veta në kuadër të garave të debatit. | and students about the topics of debates, the dynamics of the competition for participation in debate competitions, so that each interested school can apply with one or several teams within the debate competitions. | učenike o teme debata, dinamici konkursa za učešće na debatnim takmičenjima, tako da svaka zainteresovana škola može da se prijavi sa jednom ili više ekipa u okviru takmičenja u debatama. |
| 4. Organizatat e specializuara të përzgjedhura nga MASHTI për organizimin e debateve të standardizuar (nën mbikëqyrjen e komisionit të MASHTI): | 4. Specialized organizations selected by MESTI for the organization of standardized debates (under the supervision of the MESTI commission): | 4. Specijalizovane organizacije koje izabere MONTI za organizovanje standardizovanih debata (pod nadzorom komisije MONTI-a): |
| 4.1. Hartojnë përmbajtjen e konkursit dhe organizojnë garat, në bazë të kushteve dhe kritereve të përcaktuara nga MASHTI; | 4.1. Compile the content of the competition and organize competitions, based on the conditions and criteria set by MESTI; | 4.1. Sastavlja sadržaj konkursa i organizuje takmićenja, na osnovu uslova i kriterijuma koje postavlja MONTI; |
| 4.2. Organizojnë trajnim themelor mbi këto formate të debatit për të gjithë nxënësit/ekipet që janë paraqitur në konkurs; | 4.2. Organize basic training on these debate formats for all students / teams that have entered the competition; | 4.2. Organizuju osnovnu obuku o ovim formatima debate za sve učenike/ekipe koji su se prijavili na takmičenje; |
